




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	Deputetët e Kuvendit Poslanike Skupštine Members of the Assembly	DATE DATU M	09.02.2023
		DATE Reference	L-VIII SP-095
NGA / OD / FROM	Glauk KONJUFCA Kryetar i Kuvendit / Predsednik Skupštine / President of the Assembly		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Seanca plenare / Plenarna sednica / Plenary Session		

Seanca plenare e Kuvendit do të mbahet të hënën, më 13.02.2023, në orën 12:00, në sallën e Kuvendit.

Ftohen deputetët e Kuvendit.

Rendi i ditës është i bashkëngjitur.

Plenarna sednica Skupštine održaće se u ponedeljak, 13.02.2023, u 12:00 časova, u sali Skupštine.

Pozivaju se poslanici Skupštine.

Dnevi red je u prilogu.

Plenary Session of the Assembly will take place on Monday, 13.02.2023, at 12:00, Assembly Hall.

Members of the Assembly are invited to attend.

The Agenda for the meeting is attached.

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar për zhvillimet në dialogun ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Dnevni red

1. Parlamentarna rasprava o razvoju u dijalogu između Republike Kosovo i Republike Srbije

Agenda

1. Parliamentary debate on the development regarding the dialogue between the Republic of Kosovo and Republic of Serbia.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

08/3411/Do-1448

09.02.2023

Për: Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës
Z. Glauk Konjufca, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Nga: Abelard Tahiri, Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, në emër të deputetëve nënshkrues

Lënda: Mocion Përmbajtjesor

Data: 09 shkurt 2023

Në mbështetje të nenit 65, paragrafët I dhe 9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 58 të Rregullores së Kuvendit, deputetët nënshkrues parashtrojnë këtë mocion përmbajtjesor:

Çështja: Debat parlamentar për zhvillimet në dialogun ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë;

A r s y e t i m

Pas dhënies së mendimit këshilldhënës nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) rreth aktit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 9 shtator 2010, kishte miratuar rezolutën e sponsorizuar nga 27 vendet e atëhershme të Bashkimit Evropian, e cila hapi rrugë për fillimin e dialogut Kosovë - Serbi, të lehtësuar nga BE, me qëllimin që ky proces do të shërbente si faktor i paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon.

Si rezultat, më 10 mars 2011, Kuvendi i Kosovës miratoi një rezolutë e cila e mandatonte Qeverinë e Republikës së Kosovës për të nisur bisedimet teknike me Serbinë, si dhe i kërkonte asaj që të raportonte në baza të vazhdueshme për rrjedhën e procesit. Krahas bisedimeve teknike, në fund të vitit 2012 filluan edhe bisedimet politike për normalizim të marrëdhënieve. Me 18 tetor 2012, Kuvendi i Kosovës miratoi një rezolutë të re përmes së cilës përkrahte fillimin e dialogut politik duke mandatuar sërish Qeverinë e Kosovës për të udhëhequr me këtë proces.

Derisa procesi i dialogut, ndër vite, ka pasur dinamika të ndryshme, gjithsesi është arritur progres në disa segmente. Janë nënshkruar dhjetra marrëveshje, një pjesë e konsiderueshme e të cilave janë zbatuar.

Megjithatë, derisa pak vite më parë procesi i dialogut konceptohej se kishte hyrë në fazën përfundimtare të tij, me qëllimin që të kurorëzohej me arritjen e një marrëveshje ligjërishme të obligueshme në mes palëve, në dy vitet e fundit procesi ka hyrë në një rrugë që duket se nuk çon në këtë marrëveshje.

Rrjedhimisht, mbetet shqetësuese edhe qasja e Qeverisë së Republikës së Kosovës në raport me disa çështje që lidhen me këtë proces, duke përfshirë dhe mos u kufizuar edhe në raport me transparencën dhe llogaridhënien që duhet t'a karakterizoj të njëjtin.

Prandaj, duke qenë detyrë primare kushtetuese e Kuvendit mbikëqyrja e punës së Qeverisë, është i domosdoshëm trajtimi dhe informimi me urgjencë rreth zhvillimeve që kanë ndodhur dhe janë duke ndodhur në procesin e dialogut.

Për sa më sipër, ne deputetet e grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, nënshkruar të këtij mocioni, kërkojmë mbajtjen e seancës së Kuvendit me qëllim të zhvillimit të debatit parlamentar për temën e lartshënuar dhe mirëpresim caktimin e të njëjtës nga Kryesia e Kuvendit.










Po ashtu, ju njoftojmë se me pajtimin e grupeve të tjera parlamentare (pozitë dhe opozitë), propozojmë që ky debat të mbahet më datë 13 shkurt 2023, duke filluar nga ora 12:00.

Për arsyet e cekura më sipër, ne, deputetët e grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, krahas këtij mocioni përmbajtjesor, propozojmë edhe draftin e Rezolutës e cila do të prezantohet për miratim në seancën plenare.

Bashkëngjitur:

- *Nënshkrimet e deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, parashtrues të këtij mocioni;*

Lista e deputetëve nënshkrues të mocionit përmbajtjesor:

1. ABELARD TAHIRI 
(Emri dhe mbiemri) (Nënshkrimi)
2. GANIME TE MUSLIM 
(Emri dhe mbiemri) (Nënshkrimi)
3. Arjana Musliu Shahi 
(Emri dhe mbiemri) (Nënshkrimi)
4. ELMI REFICA 
(Emri dhe mbiemri) (Nënshkrimi)
5. Fevat Yhaja 
(Emri dhe mbiemri) (Nënshkrimi)
6. FLORETË ZEJNUKATU 
(Emri dhe mbiemri) (Nënshkrimi)
7. Bekim Haxhiu 
(Emri dhe mbiemri) (Nënshkrimi)
8. HAJJAR BEGA 
(Emri dhe mbiemri) (Nënshkrimi)
9. RASHIT QALAJ 
(Emri dhe mbiemri) (Nënshkrimi)
10. _____
(Emri dhe mbiemri) (Nënshkrimi)
11. _____
(Emri dhe mbiemri) (Nënshkrimi)